




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/3568/18
Dep. 02	Prot. No.
Nr. Fraq.	Data 19.10.2018
Broj. Stanica	Datum
Nr. dani	Data



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të të Rregullores nr. 01/2018 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 Të Punës Së Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 19.10.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1022/18, për zyrtarin e lartë z. Jonuz Salihaj, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-1022/18, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Jonuz Salihaj, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, janë ndërmarr veprimet e parapara ligjore dhe është zhvilluar procedurat e paraparë për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.

Ky rast, ka filluar të shqyrtohet pas një informate të dërguar në adresë të AKK-së, dhe sipas procedurës së paraparë janë analizuar informatat dhe është bërë verifikimi i informacionit dhe të dhënave tjera të siguruar edhe nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), ku është vërejtur se zyrtari i lartë z. Jonuz Salihaj, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër Shkolla Fillore dhe e Mesme "ZENIT", e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.06/L-011, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit

të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Jonuz Salihaj, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u zhvilluar.

Zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit kanë shfrytëzuar kërkesën e zyrtarit z. Salihaj, dhe kanë organizuar në zyrat e AKK-së një takim me z. Jonuz Salihaj.

Ne takimin e organizuar zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar, duke e njoftuar se figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër Shkolla Fillore dhe e Mesme "ZENIT"

Ne këtë takim zyrtari i lartë z. Jonuz Salihaj, pasi është informuar me faktet e prezantuara, ka deklaruar se nuk punon në Shkollën Fillore dhe të Mesme "ZENIT" dhe nuk e ushtron funksionin e personit të autorizuar të këtij biznesi, pasi që ka ndërpre kontratën me këtë biznes që nga Janari i vitit 2017, por ka theksuar se nuk ka qenë i informuar se akoma figuron si person i autorizuar i këtij biznesi, por është zotuar se do të ndërmarr veprime sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi nga Institucioni kompetent. Pas këtij takimi z. Jonuz Salihaj, na ka njoftuar se ka probleme teknike për tu larguar nga personi i autorizuar në biznes, mirë po i njëjti ka theksuar se ka bërë kërkesë në organin kompetent (ARBK) që ta largoj nga funksioni si person i autorizuar pasi që nuk punon fare në këtë biznes që nga Janari i vitit 2017, andaj ka kërkuar mirëkuptim nga AKK, deri në përfundimin e procedurave administrative në ARBK.

Agjencia kundër Korrupsionit duke pas parasysh se ky proces po zgjat i ka bërë edhe shpresën e dytë paralajmëruese z. Jonuz Salihu, dhe e ka njoftuar për pasojat që mund të ketë nëse nuk ndërmerr hapat për evitimin e Konfliktit të Interesit.

Pas këtyre veprimeve nga zyrtari i lartë z. Jonuz Salihaj, kemi pranuar informatën se është larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznes, po ashtu kemi pranuar edhe dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z. Jonuz Salihaj, nuk figuron me si person i autorizuar në biznes me emër Shkolla Fillore dhe e Mesme "ZENIT".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Jonuz Salihaj, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, duke u larguar nga pozita si person i autorizuar në biznes, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

